



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Kuvendi - Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura III**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,  
Barazi Gjinore, Personat të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 18  
Prishtinë, më 16. 9. 2008, ora 12:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-17

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Shpresa Murati, Naim Rustemi dhe Vezira Emrush – anëtarë.

Drita Maliqi dhe Radmila Vujovic nuk ishin të pranishëm, sepse ishin në udhëtim zyrtar.  
Mbledhjen e monitoruan:

- Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj dhe Sulltane Gashi

Mbledhjen e kryesoi Ismet Beqiri - kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

**R e n d d i t e**

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
- 2 Shqyrtimi i peticioneve,
- 3 Të ndryshme.

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

*Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

*Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.*

**2 Shqyrtimi i peticioneve**

*Kryetari i njoftoi të pranishmit lidhur me pikën e rendit të ditës dhe e ftoi raportuesen ta marrë fjalën.*

**Prof. dr. Nerxhivane Dauti** i raportoi Komisionit për përmbajtjen e disa shkresave dhe për zgjidhjen e tyre si vijon:

**Shkresa** nr. 03-0915/D0-546 e datës 19. 8. 2008, e parashtruar nga Elife Ajeti nga Gjilani, ka të bëjë me zvarritjen e procedurës gjyqësore që nga viti 2002 nga Gjykata Komunale e Gjilanit.

Komisioni rekomandon që Gjykata Komunale e Gjilanit të marrë masa për përsheptimin e procedimit të padisë C. nr. 51/02 dhe kërkon ta informojë Komisionin për ecurinë e zhvillimit të procedurës.

**Shkresa** nr. 01-399 e datës 16. 7. 2008, e parashtruar nga Fatime Jasiqi nga Deçani, drejtore në SHF "Edmond Hoxha", KK Junik, shpreh shqetësimin se nuk është përfshirë në listën e pagave.

Pas debatit që e zhvilloi Komisioni lidhur me këtë shkresë u pajtua dhe e nxori këtë:

### **P e r f u n d i m**

*Komisioni vendosi t'i ftojë znj. Fatime Jasiqi dhe përfaqësuesin e MASH-it, në shqyrtimin e ankesës të së lartpërmendurës, në njërën nga mbledhjet e radhës.*

**Ankesa** nr. 01-91/2008 e datës 4. 9. 2008, e ushtruar nga Instituti i Historisë së Kosovës, në të cilën theksohet se vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 08/29, i datës 31. 7. 2008, nuk ka mbështetje ligjore-kushtetuese, është i dëmshëm dhe cek se mbajtja dhe përdorimi i ndërtesës nga ana e Institutit të Historisë është kusht dhe premisë e domosdoshme për realizimin e objektivave me rëndësi kombëtare. Pas shqyrtimit të ankesës së Institutit të Historisë Komisioni njëzëri propozoi të nxirret ky:

### **R e k o m a n d i m**

*Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione vlerëson se vendimi i Qeverisë së Kosovës për dhënien në shfrytëzim të objekti të Institutit të Historisë për nevojat e Bibliotekës Kombëtare Universitare është i ngutshëm dhe i kundërligjshëm dhe rekomandon të rishqyrtohet.*

**Ibrahim Makolli** – Komisioni kërkon që shqetësimi i Institutit të Historisë t'i paraqitet Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të përfshihet si pikë në agjendën e tij. Arsyetimin e bazon në atë se kjo do të kontribuojë në të mirë të Kuvendit dhe të qytetarëve.

### **3. Te ndryshme**

**Prof. dr. Nerxhivane Dauti** - Lidhur me Programin e Qeverisë së Kosovës për barazi gjinore, theksoi se ka mangësi dhe kërkoi t'i bëhet një analizë më e thellë.

**Sanije Alijaj** - Komisionin e informoi për rekomandimet që duhet t'i bashkëngjiten Programit të Qeverisë për barazi gjinore. Ishte konstatim i përgjithshëm të organizohet një tryezë lidhur me Programin për barazi gjinore me të gjithë aktorët.

Lidhur me këtë pikë diskutuan deputetët: Vezira Emrush, Ibrahim Makolli, Ismet Beqiri dhe Luljeta Shehu.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

E përgatiti

Rrahim Demaj, zyrtar i lartë ligjor

**Kryetari i Komisionit**  
Ismet Beqiri